

FONDI SHQIPTAR I ZHVILLIMIT
FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

[Data : 27.06.2017]

Për: Bashkimin e Operatoreve Ekonomike “NTP Eurokos Dega Shqiperi” shpk (38%), “Arifaj” shpk (37%) dhe “Denis 05” shpk (25%).

Procedura e prokurimit: **“Tender i Hapur”** me objekt : **"Rikonstruksion i rruges se Velipojes segmenti Harku i Berdices - Baks ” Lot. 2.**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: **"Rikonstruksion i rruges se Velipojes segmenti Harku i Berdices - Baks ” Lot. 2.**

Kohëzgjatja: brënda 18 muajsh nga data e fillimit te punimeve.

Fondi limit: 703.408.000 (shtateqind e tre milion e katerqind e tete mije) Lekë pa TVSH. Fondi i akorduar per vitin 2017 eshte 140.681.640 lekë pa tvsh. Pjesa e mbetur është parashikuar për vitin 2018.

Burimi i financimit: Buxheti i Shtetit.

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: **Datë 25.05.2017.**

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Nuk ka patur.

Njoftojmë se, kanë qënë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara pa tvsh:

NR	SHOQERIA	OFERTA PA TVSH PARA KONTROLLIT ARITMETIK
1	S.M.O UNION & VEGA	415,547,008
2	VARAKU E & VELLEZERIT HYSA	435,359,225
3	ALBA KONSTRUKSION	456,433,751
4	ALBAVIA & EUROTEOREMA	459,831,078
5	DELTA LAVORI SPA & COMPANY RIVIERA 2008 & AGRI KONSTRUKSION	504,132,584
6	ALKO IMPEX GENERAL CONSTRUCCION & 2T	519,525,323
7	NTP EUROKOS DEGA SHQIPERI & ARIFAJ &	550,093,288
8	EVEREST & GPG	582,355,148
9	ALB TIEFBAU & ANK & SMO VATAKSI	583,538,901
10	VICTORIA INVEST INTERNATIONAL &	585,946,138
11	GJOKA KONSTRUKSION	589,423,083
12	GENER 2	618,138,044
13	GECI	628,477,295
14	CURRI & BE IS	651,876,735
15	BAMI	679,486,625
16	CONSORZIO ECIT	680,000,000

17	FUSHA	938,495,476
18	ADEM POJANI	NUK KA OFERTE

Pas vleresimit te dokumentacionit te paraqitur komisioni me unanimitet vendosi:

1. Te skualifikoje bashkimit e Operatoreve Ekonomike “SMO Union” shpk (28%) dhe “Vega” shpk (72%) pasi:

Shoqeria “Vega” shpk nuk ploteson Kerkesen e Pergjithshme per Kualifikim lidhur me shlyerjen e detyrimeve tatimore, pasi, bazuar ne vertetimin e paraqitur leshuar nga organet e tatim taksave, rezulton se ka detyrime tatimore ne shumen 146.167.500 leke per te cilat eshte lidhur marreveshje per ti paguar me keste. Bazuar ne vertetimin e mesiperm rezulton se shoqeria ka detyrime tatimore dhe nuk ploteson kushtin per kualifikim.

Shoqeria “Vega” shpk nuk ploteson kerkesen per kualifikim lidhur me shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri, pasi, bazuar ne vertetimin e leshuar nga OSHEE rezulton se ka detyrime ne shumen 20.634.989 leke, per te cilat eshte lidhur aktmarreveshje aktive. Bazuar ne vertetimin e mesiperm rezulton se shoqeria ka detyrime dhe nuk ploteson kushtin per kualifikim.

Duke qene se keto te meta jane thelbesore, komisioni vendosi te mos vazhdoje me vleresimin e dokumentacionit te mbetur.

2. Te skualifikoje Operatorin Ekonomik “Alba Konstruksion” shpk pasi:

Nuk ploteson kerkesen 2.3.1 per kualifikim lidhur me kryerjen e puneve te ngjashme, pasi ka paraqitur dokumentacion per realizimin e puneve te meposhtme:

- “Rruge Lushnje” . Vlera e punimeve pa tvsh te kryera ne 3 vitet e fundit per kete objekt (referuar faturave tatimore) eshte 152.588.278 leke.
- “Rruga Rreshen Urake”. Punimet per kete rruge jane kryer perpara tre viteve te fundit. Kjo rezulton e qarte nga faturat tatimore te paraqitura.
- “Rruga Ura e Shoshajve”. Vlera e punimeve pa tvsh te kryera ne 3 vitet e fundit nga shoqeria “Alba Konstruksion” shpk e cila ka kryer 96% te punimeve per kete objekt (referuar faturave tatimore) eshte 323.429.039 leke.
- “Rruga Unaza e Re Tirane”. Per kete objekt nuk jane paraqitur faturat e leshuara nga shoqeria “Alba Konstruksion” shpk, por nga shoqeria “Karl Gega Konstruksion”. Ne kete menyre kjo pune nuk mund te merret ne konsiderate.
- “Godine banimi dhe sherbimi Farke”. Kjo pune nuk mund te konsiderohet si objekt i ngjashem, pasi nuk ka asgje te perbashket me rrugen qe prokurohet.
- “Rikualifikim urban i dy shesheve ne qender te Tiranes”. Vlera e punimeve pa tvsh te kryera ne 3 vitet e fundit nga shoqeria “Alba Konstruksion” shpk e cila ka kryer 60% te punimeve per kete objekt eshte 56.485.985 leke.

Kjo shoqeri per te provuar plotesimin e kriterit per kualifikim duhet te kishte paraqitur dokumentacion per realizimin e nje pune te vetme ne tre vitet e fundit me vlere jo me pak se 351.704.000 leke pa tvsh ose te disa puneve te realizuara ne tre vitet e fundit me vlere jo me pak se 1.406.816.000 leke pa tvsh. Ky operator ekonomik, me dokumentacionin e paraqitur, nuk ploteson asnjerin prej kushteve.

Nuk ploteson kerkesen 2.3.4 per kualifikim lidhur me deklaraten per mosangazhimin e inxhinierëve, pasi ne deklaraten e paraqitur nuk shprehet sipas kerkeses “*inxhinieret e kerkuar ne piken 2.3.3 per kualifikim jane te pa angazhuar ne kontrata te tjera*”.

Nuk ploteson kerkesen 2.3.7 per kualifikim lidhur me disponimin e mjeteve pasi vetem nje nga kamionet e deklaruar eshte me kapacitet mbajtes mbi 20 ton ndersa te tjeret jane me pak se 20 ton. Gjithashtu targat e mjeteve te deklaruar ne formularin e deklarimit te mjeteve nuk perputhen me targat e mjeteve per te cilet eshte paraqitur dokumentacion.

3. Te skualifikoje bashkimin e Operatoreve Ekonomike “Albavia” shpk (51%) dhe “Euroteorema Peqin” shpk (49%) pasi:

Bashkimi i Operatoreve Ekonomike nuk ploteson kriterin per paraqitjen e deklarates mbi disponueshmërinë e mjeteve sipas Shtojcës 9 pasi deklarata nuk eshte paraqitur vecmas per secilen shoqeri. Formulari i deklarimit ne emer te te dy kompanive eshte paraqitur nga shoqeria “Euroteorema Peqin” dhe nuk eshte firmosur e vulosur nga shoqeria “Albavia” shpk. Ne deklarate nuk specifikohet se ciles shoqeri i perket secili mjet.

Shoqeria “Albavia” shpk nuk ploteson kerkesen 2.3.1 per kualifikim lidhur me kryerjen e puneve te ngjashme, pasi ka paraqitur dokumentacion per realizimin e dy puneve:

- “Ndertim rruga by pass Plepa - Rrogozhine”. Vlera e punimeve pa tvsh te kryera nga shoqeria “Albavia” shpk (80%) ne 3 vitet e fundit per kete objekt (referuar faturave tatimore) eshte 160.519.206 leke.
- “Rikonstruksion i rruges Ura Vajguore – Pashalli Bistrovicë”, realizuar ne vitet 2013 – 2014. Vlera e punimeve pa tvsh te kryera nga shoqeria “Albavia” shpk ne 3 vitet e fundit per kete objekt (referuar faturave tatimore) eshte 79.745.068 leke.

Bazuar ne perqindjen e puneve qe ka marre persiper (51%), kjo shoqeri per te provuar plotesimin e kriterit per kualifikim duhet te kishite paraqitur dokumentacion per realizimin e nje pune te vetme ne tre vitet e fundit me vlere jo me pak se 351.704.000 leke pa tvsh ose te disa puneve te realizuara ne tre vitet e fundit me vlere jo me pak se 717.476.160 leke pa tvsh.

Ky operator ekonomik, me dokumentacionin e paraqitur, nuk ploteson asnjërin prej kushteve.

4. Te skualifikoje bashkimin e Operatoreve Ekonomike “Delta Lavori” spa (47%), “Company Riviera 2008” shpk (27%) dhe “Agri Construction” shpk (26%) pasi:

Shoqeria “Delta Lavori” spa nuk ploteson Kerkesen e pergjithshme per Kualifikim lidhur me pagesen e detyrimeve fiskale dhe detyrimeve per sigurimet shoqerore pasi nuk ka paraqitur dokumentacion per pagimin e taksave dhe sigurimeve shoqerore ne itali. Ka paraqitur nje vetedeklarim, nderkohe qe dokumentat e kerkuar leshohen ne shtetin italian. Vetedeklarimi pranohet vetem kur dokumenti nuk lëshohet në shtetin e tyre të origjinës.

Shoqeria “Delta Lavori” spa nuk ploteson kerkesen per kualifikim lidhur me shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri pasi ka paraqitur vertetimin e leshuar nga OSHEE nr 10993/1 prot date 03.05.2017 sipas te cilit “Qendra Tregtare dhe e Zhvillimit Kulturor” shpk nuk ka detyrime ndaj OSHEE. Ka paraqitur gjithashtu edhe nje vertetim te leshuar nga “Qendra Tregtare dhe e Zhvillimit Kulturor” shpk e cila deklaroi se shoqeria “Delta Lavori” spa ka shlyer detyrimet per energjine elektrike, si dhe kontrate qeraje ndermjet paleve. Te gjithë dokumentet e mesiper nuk mund te provojne se shoqeria “Delta Lavori” spa nuk ka detyrime ndaj OSHEE dhe ne kete menyre kriteri nuk konsiderohet i plotesuar.

Shoqeria “Delta Lavori” spa nuk ploteson kerkesen 2.2.4 per kualifikim lidhur me likuidimin e detyrimeve vendore pasi nuk ka paraqitur dokument per pagesen e detyrimeve ne Tirane ku ka seli.

Duke qene se keto te meta jane thelbesore, komisioni vendosi te mos vazhdoje me vleresimin e dokumentacionit te mbetur.

5. Te skualifikoje bashkimin e Operatoreve Ekonomike “Alko Impex General Costrucion” shpk (74%) dhe “2T” shpk (26%) pasi:

Shoqeria “Alko Impex General Costrucion” shpk nuk ploteson kerkesen 2.3.1 per kualifikim lidhur me kryerjen e puneve te ngjashme, pasi ka paraqitur dokumentacion per realizimin e puneve te meposhtme:

- “Ndertim i rruges tranzite per Shale”. Vlera e punimeve pa tvsh te kryera ne 3 vitet e fundit per kete objekt (referuar faturave tatimore te konvertuara ne leke) eshte 225,906,300 leke.
- “Sistemime asfaltme Elbasan”. Vlera e punimeve pa tvsh te kryera ne 3 vitet e fundit nga shoqeria “Alko Impex General Costrucion” shpk e cila ka kryer 51% te punimeve per kete objekt per kete objekt eshte 24.365.320 leke.
- “Sistemime asfaltme Librazhd”. Vlera e punimeve pa tvsh te kryera ne 3 vitet e fundit nga shoqeria “Alko Impex General Costrucion” shpk e cila ka kryer 75% te punimeve per kete objekt per kete objekt eshte 58.997.041 leke.
- “Zgjerim i rruges Skenderaj”. Per kete objekt eshte paraqitur vetem nje fature tatimore. Vlera e realizuar duke ju referuar fatures tatimore te konvertuar ne leke eshte 19.172.160 leke.

Kjo shoqeri per te provuar plotesimin e kriterit per kualifikim duhet te kishte paraqitur dokumentacion per realizimin e nje pune te vetme ne tre vitet e fundit me vlere jo me pak se 351.704.000 leke pa tvsh ose te disa puneve te realizuara ne tre vitet e fundit me vlere jo me pak se 1,041,043,840 leke pa tvsh. Ky operator ekonomik, me dokumentacionin e paraqitur, nuk ploteson asnjeren prej kushteve.

Shoqeria “2T” shpk nuk ploteson kerkesen 2.2.4 per kualifikim lidhur me shlyerjen e detyrimeve per taksat vendore pasi nuk ka paraqitur vertetim per pagesen e taksave vendore ne Elbasan (Qukes) ku ushtron aktivitet nga data 07.03.2016, (referuar ekstraktit historik).

Duke qene se keto te meta jane thelbesore, komisioni vendosi te mos vazhdoje me vleresimin e dokumentacionit te mbetur.

6. Te skualifikoje bashkimin e Operatoreve Ekonomike “Victoria Invest International” shpk (51.07%) dhe “Victoria Invest” shpk (48.93%) pasi:

Shoqeria “Victoria Invest International” shpk nuk ploteson kerkesen 2.3.1 per kualifikim lidhur me kryerjen e puneve te ngjashme, pasi ka paraqitur dokumentacion per realizimin e dy puneve:

- “Rruga Librazhd Qafe Stude”, realizuar ne vitet 2011 – 2015. Vlera e punimeve pa tvsh te kryera ne 3 vitet e fundit per kete objekt (referuar faturave tatimore) eshte 112.818.660 leke.
- “Rruga Grekan Vlashuk”, realizuar ne vitet 2013 – 2014. Vlera e punimeve pa tvsh te kryera ne kete objekt eshte 378.867.823 leke. Vlera e punimeve te kryera ne tre vitet e fundit (referuar faturave tatimore) eshte 139.915.701 leke pa tvsh.

Bazuar ne perqindjen e puneve qe ka marre persiper (51.07%), kjo shoqeri per te provuar plotesimin e kriterit per kualifikim duhet te kishte paraqitur dokumentacion per realizimin e nje pune te vetme ne tre vitet e fundit me vlere jo me pak se 351.704.000 leke pa tvsh ose te disa puneve te realizuara ne tre vitet e fundit me vlere jo me pak se 718.460.931 leke pa tvsh.

Ky operator ekonomik, me dokumentacionin e paraqitur, nuk ploteson asnjeren prej kushteve.

Shoqeria “Victoria Invest International” shpk nuk ploteson kerkesen 2.3.2 per kualifikim lidhur me numrin mesatar te te punesuarve pasi sipas perqindjes se punes qe ka marre persiper (65.04%) duhet te kete mesatarisht 90 punonjes. Numri mesatar i punonjesve per degen e shoqerise ne shqiperi eshte 18 punonjes, ndersa per shoqerine meme ne Kosove eshte mesatarisht 68 punonjes per vitin 2016 dhe mesatarisht 62 punonjes per muajt janar – mars 2017. Ne total numri mesatar i punonjesve eshte 84 punonjes, me i vogel se numri i kerkuar.

7. Te skualifikoje bashkimin e Operatoreve Ekonomike “Curri” shpk (82%) dhe “Be-Is” shpk (18%) pasi:

Shoqeria “Curri” shpk nuk ploteson kerkesen 2.3.3 per kualifikim lidhur me punesimin e inxhinierëve, pasi nuk ka paraqitur asnje dokument per punesimin e inxhinierëve te kerkuar. Te gjithë inxhinieret e deklaruar ne deklaraten per stafin (paraqitur nga shoqeria “Curri” shpk) jane te punesuar nga shoqeria “Be-Is” shpk e cila ka marre persiper te kryeje vetem 18% te punimeve.

Shoqeria “Curri” shpk nuk ploteson kerkesen 2.3.7 per kualifikim lidhur me disponimin e mjeteve te nevojshme teknike per realizimin e kontrates, pasi ka marre persiper punime mbushje ne rruge, punime betoni, dhe, referuar formularit te deklarimit te mjeteve, nuk ka paraqitur dokumentacion per disponimin e nje greideri, gurëthyes, frontoje, impiant automatik betoni, pompe betoni. Keto mjete jane te domosdoshem per realizimin e punimeve qe ka marre persiper.

Shoqeria “Curri” shpk nuk ploteson kerkesen 2.2.4 per kualifikim lidhur me shlyerjen e detyrimeve per taksat vendore pasi nuk ka paraqitur vertetim per pagesen e taksave vendore ne Vlore ku ushtron aktivitet nga viti 2016 e ne vazhdim (referuar deklarates se puneve ne proces), Cerme ku ushtron aktivitet nga viti 2016 e ne vazhdim (referuar deklarates se puneve ne proces), Vau Dejes ku ushtron aktivitet nga muaji prill 2017 e ne vazhdim (referuar deklarates se puneve ne proces).

Shoqeria “Curri” shpk nuk ploteson kerkesen 2.2.5 per kualifikim lidhur me deklaraten per taksat vendore pasi deklarata e paraqitur, duke pare se nuk jane paguar taksat ne gjithë vendet e ushtrimit te aktivitetit, rezulton e rreme.

Duke qene se keto te meta jane thelbesore, komisioni vendosi te mos vazhdoje me vleresimin e dokumentacionit te mbetur.

8. Te skualifikoje Operatorin Ekonomik “Bami” shpk pasi:

Nuk ploteson kerkesen 2.2.3 per kualifikim lidhur me gjendjen ne banke, pasi ka paraqitur vertetim se disponon shumen 2.000.000 (dy milion) leke nga 98.169.100 leke qe duhet te dispononte.

9. Te skualifikoje Operatorin Ekonomik “Consortio Stabile Ecit” shpk pasi:

Nuk ploteson kerkesen 2.3.1 per kualifikim lidhur me kryerjen e puneve te ngjashme, pasi objekti i deklaruar ”Tender i integruar per projektimin ekzekutiv dhe realizimin e punimeve te nyjes se re hekurudhore industriale dhe portuale midis zones industriale dhe stacionit te Tukuranos” nuk mund te konsiderohet si objekt i ngjashem pasi jane punime hekurudhore dhe ne te njejten kohe nuk jane paraqitur faturat tatimore ne perputhje me kerkesen per kualifikim.

Nuk ploteson kerkesen 2.3.3 per kualifikim lidhur me punesimin e inxhinierëve, pasi:

- Nuk ka paraqitur dokumentacion per punesimin e nje inxhinieri ndertimi me profil transport.
- Nuk ka paraqitur kontraten e punes se ing. Mjedisit Ardiona Memetaj.

Nuk ploteson kerkesen 2.3.6 per kualifikim lidhur me disponimin e pikave te nevojshme te licenses, pasi nuk ka paraqitur licensen perkatese.

10. Te skualifikoje Operatorin Ekonomik “Fusha” shpk pasi:

Ka paraqitur oferte per nje pune qe nuk ka asnje lidhje me punen qe prokurohet.

11. Te skualifikoje Operatorin Ekonomik “Adem Pojani” shpk pasi nuk ka paraqitur oferte.**12. Te skualifikoje bashkimin e Operatoreve Ekonomike “Vellezerit Hysa” shpk (70%), “Varaku E” shpk (20%) dhe “Ergi” shpk (10%) pasi:**

Ka dhene doreheqjen pasi stafi i deklaruar eshte i angazhuar ne nje kontrate tjeter ne te cilen kjo shoqeri eshte renditur ne vend te pare.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **Bashkimin e Operatoreve Ekonomike “NTP Eurokos Dega Shqiperi” shpk (38%), “Arifaj” shpk (37%) dhe “Denis 05” shpk (25%)** se oferta e paraqitur, me vlerë **550.093.288 (peseqind e pesedhjete milion e nentedhjete e tre mije e dyqind e tetedhjete e tete)** lekë pa TVSH është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë **Autoritetit Kontraktor:**

- **Fondi Shqiptar i Zhvillimit**
- **Rr. “Sami Frashëri”, Nr. 10, Tirana, Albania**
- **Phone: 00355 4 2 235 597/8 (int.151)**
- **Fax: 00355 4 2 234 885**

sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda pese ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë **06.06.2017**.

Ne daten 09.06.2017 paraqiti ankim shoqeria “SMO Union” shpk. Ankimit ju kthye pergjigje ne daten 12.06.2017 duke e refuzuar ate.

Ne daten 13.06.2017 paraqiti ankim shoqeria “Delta Lavori” shpk. Ankimit ju kthye pergjigje ne daten 15.06.2017 duke e refuzuar ate.

Ne daten 14.06.2017 paraqiti ankim shoqeria “Albavia” shpk. Ankimit ju kthye pergjigje ne daten 15.06.2017 duke e refuzuar ate.

Afatet e ankimit kane perfunduar.